



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.493/2022  
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 23 dhe 32 paragrafi 10 i Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Z. Arsim Bajraktari, përzgjedhet zëvendës administrator i Gjykatës së Apelit.
- II. Mandati i z. Bajraktari si zëvendës administrator do të filloj nga data 01 janar 2023 dhe është pa afat të caktuar.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.256/2022, ka shpallur konkurs për pozitë të lirë për zëvendës administrator të Gjykatës së Apelit. Komisioni për rekrutimin e kandidatëve për pozitën zëvendës administrator të Gjykatës së Apelit, i ka rekomanduar KGJK-së dy (2) kandidatë.

Këshilli, në takimin e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, pas shqyrtimit të rekomandimit të komisionit, me votim të fshehtë dhe shumicë të votave, përzgjedhi dhe emëroi z. Arsim Bajraktari zëvendës administrator të Gjykatës së Apelit, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Arsim Bajraktari, zëvendës administrator i Gjykatës së Apelit;
- Kryetarit të Gjykatës së Apelit;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.

